

MIRATOHET

PËR KTKM

Sekretari i KTKM

ARTA DOLLANI



RELACION TEKNIKE

Rishikim i Projektit të Restaurimit

“KISHA SHËN E PREMTE”,

Faza I-rë, Lukovë

2021



PERMBAJTJA

01_VENDNDODHJA

02_PËRSHKRIM HISTORIK DHE ARKITEKTONIK

03_ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË MONUMENTIT.


04_NDËRHYRJET RESTAURUESE TË PROPOZUARA





01_VENDNDODHJA

Kisha “Shën e Premte” ndodhet në Lukovë-Sarandë.



2_PËRSHKRIM HISTORIK DHE ARKITEKTONIK

Është një kishë e tipit bazilikal me kupolë trefishe, me përmasa të brendëshme 12.6 x 6.3 m. Kollonat që ndajnë nefet janë të lidhura ndërmjet tyre dhe me muret veriore e jugore me harqe me drejtim tërthor.

Në nefin qendror harqet krijojnë brinjë qëndrueshmërie për qemerin cilindrik që mbulon atë, ndërsa në nefet anësore harqet kufizojnë bërthama të mbuluara me qemerë cilindrikë të cilat hapen ndaj nefit qendror.

Hapësira e dytë nga lindja, mbulohet me kupolë e cila ngrihet mbi një tambur të lartë. Ambjenti i altarit zgjeron hapësirën e tij nëpërmjet daljes jashtë të hapësirës së bëmës.

Kisha ka hyrje nga ana jugore dhe ajo perëndimore drejtpëdrejtë nga jashtë. Kishës i mungojnë narteksti dhe hajati, tipar ky i takuar edhe në kishat e tjera të bregdetit. Interieri ndriçohet dobët nga dritare të ngushta në formë frëngjie të hapura në muret jugore, perëndimore dhe në tambur.

Kisha është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, të vendosura në radhë të rregullta në muraturë. Fugaturat janë të rrafshuara mirë me llaç, gjë që krijon sipërfaqe të pastra të muraturës.




Rishikim I Projektit të Restaurimit: Kisha Shën e Premtes, Faza I-rë, Lukovë



Muratura përfundon me një kornizë të thjeshtë prej guri. Në ndryshim nga pjesa tjetër, apsida është e përpunuar me nike të harkuara nga sipër duke i dhënë muraturës së saj më tepër relief.


Çatia është dyjëshe dhe ndërpritet vetëm në pjesën qendrore nga volumi tetëfaqësh i tamburit.

Në mungesë të të dhënave epigrafike, duke bërë paralelizma me kishat e tjera të bregdetit, mendojmë se kisha e Lukovës duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVII.




Prerje terthore


Plani I dimensionimit



Prerje Gjatesore



Fasada veriore



Fasada perendimore





03_ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË MONUMENTIT.

Situata ne Kishen Shen e Premte ne fshatin Lukove paraqitet edhe me e renduar si rezultat i kushteve atmosferike te javes se dyte te janarit. Gjithashtu rreshjet e shiut te diteve te fundit kane ndikuar ne degradimin edhe me teper te lidhjeve ne seksionet e muratures qe perbejne kete kishë. Ne kushtet aktuale ky monument paraqet rrezikshmeri per sigurine e vizitoreve dhe besimtareve.

Duke qene se ne kishë nuk jane kryer asnjehere nderhyrje restauruese dhe as nderhyrje mirembajtese gjendja e konservimit te saj eshte shume e degraduar, aq sa nje pjese e catise se objektit eshte e rrezuar. Rreth 30-35% e siperfaqes se catise, tashme eshte e rrezuar, konkretisht zona jug-perendimore e kishes. Rreshqitjet e terrenit ne pjesen perendmore te kishes si dhe rrenjet e ligustres te mbira ne terren ngjitur me muraturen e objektit, ne faqen perendimore dhe veriore. Keto rrenje, per shkak te mungeses se mirembajtjes jane rritur duke cuar diametrin e kerellit-trungut deri ne 10 em (jane disa rrenje te mbira ngjitur me njera tjetren) si dhe deget e tyre jane zgjatur dhe shtrire ne e gjithë qoshen veriperendimore te muratures se kishes dhe duke u zgjatur ne vijim mbi te gjithë siperfaqen e catise. Deger e ligustres duke u rritur kane mundur te depertojne ne brendesi te muratures dhe catise duke shperbere lidhesin dhe duke shkeputur materialin e ndertimit nga njeri tjetri. Ne kete menyre, struktura e muratures dhe catise jane degraduar dhe kane humbur aftesine mbajtese.

Muratura. Nga te gjitha faqet e kishes, me e degraduara shfaqet ajo perendimore, e cila ka humbur teresisht aftesine mbajtese dhe eshte ne rrezik shembjeje ne cdo moment. Shkak per keto degradime jane rreshqitjet e terrenit ne anen perendimore te kishes, per te cilat nuk eshte bere asnje perpjekje per ti vene nen kontroll. Rrenjet e ligustres te mbira ne qoshen veriperendimore dhe deget e tyre te cilat jane nderfutur thelle ne murature kane demruar se tepermi lidhjen midis gureve duke bere qe ne disa fragmente muratura te kete rene krejtesisht ose te manifestoje te cara te thella sa gjithë gjeresia e muratures dhe te gjera deri ne 30 cm. Me stabel nga pikepamja statike paraqitet pjesa lindore e kishes. Terreni ne kete pjese eshte me i qendrueshem se pjesa perendimore si edhe nuk ka prezence bimesie te mbire ne murature te gjithë faqen lindore (perfshire edhe absiden), ne gjysmen lindore te muratures jugore dhe asaj veriore si dhe ne gjysmen lindore te catise (perfshire kupolen dhe tamburin mbi te cilin mbeshtetet ajo).

Kupola dhe tamburi gjithshu nuk manifestoje degradime per sa i perket qendrueshmerise se tyre statike. Megjithate gjendja e plote e konservimit ne kete zone do te ekzaminohet vetem pas nderhyrjeve ne fazen e pare, pasi te mundesohet tharja dhe heqja e bimesise prezente ne cati dhe tambur e kupole, si dhe pasi te zbulohet e gjithë catia nga rrasat e gurit.

Dyshemeja. Dyshemeja e kishes, eshte e shtruar me pllaka guri gelqeror me ngjyre bezhe drejtkendore 30x50 cm dhe spesor 3cm. Ne qender te naosit, pothuaj nen kupole eshte




Rishikim I Projektit të Restaurimit: Kisha Shën e Premtes, Faza I-rë, Lukovë



realizuar nje mozaik me pllaka guri te vendosura ne forme rrathesh bashkeqendrore. Gjendja e konservimit te dyshemese, paraqitet mjaftueshem e mire; nuk ka mungese pllakash.

Me poshte po pasqyrojme edhe me foto gjendjen aktuale te Kishes.







Rishikim I Projektit të Restaurimit: Kisha Shën e Premtes, Faza I-rë, Lukovë



IKTK | Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri





04_NDËRHJRJET RESTAURUESE TË PROPOZUARA

Objektivat

Objekti I ndërhyrjes është kryesisht nxjerjen nga risku i monumentit duke siguruar qëndruesmerinë e tij si dhe përmirsimi I gjendjes së konservimit duke e kthyer atë në një pikë tjetër atraktive për zonën.

Ndërhyrjet e propozuara:

- Pastrim territori nga bimësia e ulët;
- Pastrim Vegjetacioni nga bimesia e ulet muri ne lartesi;
- Injektivim herbicidi ne trungjet e pemeve te mbira ne strukturat murale;
- Zbulim i catise, heqje e rrasave te gurit;
- Pastrim mbushje me dhe si dhe mbeturina te tjera nen cati;
- Cmontim mur guri;
- Puntelim I qemereve, kupoles dhe muratures;
- Restaurim mur guri me tekniken shqep-qep, me llac gelqere 1:3;
- Konsolidim strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes me teknikën e injektimit;
- Restaurim qemeri me gure te gdhendur;
- Shtrese llaci horasan mbi kupole;
- Montim,plotesim me rrasa guri mbi struktura te kurbezuara;
- Mur guri themel e xokol me llaç të përzier M 25;
- Ndertim mur guri;
- Çati HD~10m mbuluar me rrasa guri;
- F.V. tiranta druri;
- Kollona guri me llac M 25;
- Fugativim murature guri;
- F.V. breza druri pishe e stazhionuar per mbeshtetjen e catise se re etj.

Ark. Artila Vavako

Ark. Arta Dollani

Ark. Llambrino Baballeku

Ark. Daniel Pirushi

Ing. Denisa Shehu

Ing. Leonard Hysi

Artila
Vavako

Digitally signed by
Artila Vavako
Date: 2021.02.24
10:19:32 +02'00'

Llambrino
Baballeku

Digitally signed by
Llambrino Baballeku
Date: 2021.02.24
01:29:02 +02'00'

Denisa
Shehu

Digitally signed by
Denisa Shehu
Date: 2021.02.24
01:30:42 +02'00'

Daniel
Pirushi

Digitally signed by
Daniel Pirushi
Date: 2021.02.24
01:54:05 +02'00'

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta
Dollani
Date: 2021.02.24
02:05:32 +02'00'

IKTK | Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta
Dollani
Date: 2021.03.08
01:24:49 +02'00'

